



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 362/13 prot.

Datë 10.03.2026

V E N D I M

Nr. 372/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

| | |
|------------------|------------|
| Fiorent Zguro | Nënkryetar |
| Kreshnik Ternova | Anëtar |
| Anila Malaj | Anëtar |
| Gjergj Mersini | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 10.03.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. **329/2026**, datë 03.03.2026 për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-67706-11-04-2025, me objekt “Sistemim asfaltim i rrugëve në territorin e njësisë administrative Thumanë, Bashkia Krujë ‘Marrëveshje kuadër me afat vlefshmërie 12 muaj (dymbëdhjetë) muaj”, me fond limit 102,170,900.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 20-11-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Krujë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” SHPK me NIPT J91915001P dhe adresë Lagjia Zall - Mner i Ri, Rruga Nacionale Kamëz, 1054, Kamëz
- Operatori ekonomik “LIS KONSTRUKSION” SHPK me NIPT K66613407H dhe adresë Lagjia Minatori, Rruga e Spitalit, Pallati nr.12, Shk.1, Kati 5, Ap.15, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Krujë me adresë Krujë, Qendër, Sheshi “Mustafa Merlika”
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 03.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. **329/2026**, ku vendosi: [...]

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-67706-11-04-2025, me objekt “Sistemim asfaltim i rrugëve në territorin e njësisë administrative Thumanë, Bashkia Krujë ‘Marrëveshje kuadër me afat vlefshmërie 12 muaj (dymbëdhjetë) muaj”, me fond limit 102,170,900.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 20-11-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Krujë.*
2. *Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Lis Konstruksion” SHPK për procedurën e prokurimit të mësipërme.*
3. *Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedurës së prokurimit sipas konstatimeve të Komisionit të Prokurimit Publik.*
4. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.*
5. *Ngarkohet zyra e financës që të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Almo Konstruksion” Shpk.*
6. *Ngarkohet zyra e financës që të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në buxhetin e shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Lis Konstruksion” Shpk.*
7. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
8. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën me nr. 1741/1 prot., datë 06.03.2026 me lëndë “Dërgim informacioni”, protokolluar me tonën me nr. 362/10 prot., datë 09.03.2026 autoriteti kontraktor Bashkia Krujë njofton se ka zbatuar vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr. **329/2026**, datë 03.03.2026 për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-67706-11-04-2025, me objekt “Sistemim asfaltim i rrugëve në territorin e njësisë administrative Thumanë, Bashkia Krujë ‘Marrëveshje kuadër me afat vlefshmërie 12 muaj (dymbëdhjetë) muaj”, me fond limit 102,170,900.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 20-11-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Krujë. Bashkëlidhur autoriteti kontraktor ka dorëzuar Procesverbal me nr. 1741 prot., datë 06.03.2026, “Mbi kalimin e fazës së procedurës së prokurimit në rivlerësim të procedurës së prokurimit me objekt “Sistemim asfaltim i rrugëve në territorin e njësisë administrative Thumanë, Bashkia Krujë”, me nr. REF-67706-11-04-2025”.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën me nr. 1741/1 prot., datë 06.03.2026 me lëndë “Dërgim informacioni”, protokolluar me tonën me nr. 362/10 prot., datë 09.03.2026 autoriteti kontraktor Bashkia Krujë njofton se ka zbatuar vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr. **329/2026**, datë 03.03.2026 për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-67706-11-04-2025, me objekt “Sistemim asfaltim i rrugëve në territorin e njësisë administrative Thumanë, Bashkia Krujë ‘Marrëveshje kuadër me afat vlefshmërie 12 muaj (dymbëdhjetë) muaj”, me fond limit 102,170,900.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 20-11-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Krujë.

II.2. Referuar shkresës me nr. 1741/1 prot., datë 06.03.2026, si dhe nga verifikimi i kryer në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE), Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës së prokurimit në përputhje me vendimin me nr. **329/2026**, datë 03.03.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik.

II.3. Sa më sipër arsyetuar autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik me nr. **329/2026**, datë 03.03.2026.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur” me Nr. REF-67706-11-04-2025, me objekt “Sistemim asfaltim i rrugëve në territorin e njësisë administrative Thumanë, Bashkia Krujë ‘Marrëveshje kuadër me afat vlefshmërie 12 muaj (dymbëdhjetë) muaj”, me fond limit 102,170,900.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 20-11-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Krujë.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

